

MMR DHE AUTIZMI: VËRTETIMI SHKENCOR KUNDËR DEZINFORMIMIT



Shpresa Kushaj- Sadriu

Doktor i Mjekësisë

Abstrakti

Edhe 27 vjet pas botimit të artikullit të rrejshëm nga mjeku Andrew Wakefield, "Ileal-lymphoid-nodular hyperplasia, non-specific colitis, and pervasive developmental disorder in children" në revistën Lancet, në vitin 1988, ku pas një studimi të bërë në 12 fëmijë me çrregullime të spektrit autik dhe pa grup kontroll, Wakefield pretendonte se ekzistonte një lidhje midis vaksinës MMR (Morbill, Mumps, Rubeola) dhe autizmit, pasojat e këtij artikulli vazhdojnë të kenë ndikimin e tyre në rënien e përqindjes së vaksinimit dhe në kërcnimin e shëndetit publik, duke shkaktuar kohë pas kohe shpërthime të epidemive të fruthit. Artikulli në fjalë është tërhequr në vitin 2010 për mashtrim dhe manipulim të dhënash. Dr. Andrew Wakefield i është ndaluar e drejta për ushtrimin e profesionit. Artikulli ynë ka përmbledhur disa nga punimet më të rëndësishme, më të cituara, të cilat gjatë dekadës së fundit kanë dhënë dëshmi shkencor dhe kanë hedhur poshtë disa herë, supozimin e rrejshëm që ekziston një lidhje mes vaksinës së MMR dhe autizmit. Metoda e perzgjedhjes së artikujve, ka qenë duke përdorur fjalët kyçe: MMR vaccine and autism, MMR vaccine safety, MMR vaccine side effects. Për secilin artikull janë përmendur autorët, viti i publikimit, vendi, mostra dhe gjetjet më të rëndësishme, të paraqitura edhe në tabelë përmbledhëse. Konkluzioni nga rishikimi i këtyre artikujve është se nuk ka lidhshmëri mes MMR dhe autizmit, duke shtuar evidencë shkencore mbi këtë temë.

Fjalët kyçe: MMR vaccine and autism, MMR vaccine safety, MMR vaccine side effects

Hyrja

Pas artikullit të dr. Andrew Wakefield, i botuar në revistën Lancet, i cili ka pasur shumë kufizime si një mostër të vogël prej dymbëdhjetë fëmijësh me çrregullime të spektrit autik dhe i cili është tërhequr për shkelje të rënda, pasojat për shëndetin publik ishin mjaft të rënda. Qarkullimi i kësaj dezinformate së cilës mediat, e sidomos interneti që në atë kohë po bëhej shumë i përdorur, por edhe një grup i caktuar i njerëzve që janë kundër vaksinimit, i dhanë zë dhe bujë,

ka pasur pasojë të rënda për shëndetin publik, duke bërë që, kohë pas kohe, të ketë shpërthime të epidemive të fruthit.

Edhe në vendin tonë, nga data 05.05.2025 deri më datën 13.05.2025 janë raportuar 9 raste të fruthit dhe në anketat epidemiologjike, 6 nga prindërit kanë pohuar se arsyeja se përse nuk u kanë dhënë vaksinën është frika se kjo vaksinë do t'u shkaktonte fëmijëve të tyre autizëm.

Ajo çka është edhe më serioze është se disa nga prindërit kanë raportuar se kështu janë udhëzuar nga mjekë: pediatër apo psikologë. Kjo e vë në pah rëndësinë e këtij artikulli, në mënyrë që së pari i gjithë opinioni mjekësor të sqarohet mbi të vërtetën dhe mjekët të jetë të një mendimi dhe qëndrimi të përbashkët sa i përket vaksinimit të fëmijëve sipas moshës.

Materialet dhe metodat:

Qëllimi i punimit. Ky punim është bërë me qëllim që edhe për njëherë të mund të sqarohet opinioni i gjerë i profesionistëve shëndetësor mbi të vërtetën shkencore për sigurinë e vaksinës MMR dhe hudhjen poshtë të mitit mbi një lidhje të mundshme mes vaksinës MMR dhe autizmit.

Strategjia e kërkimit. Për këtë punim janë kërkuar databazat e besueshme si Google Scholar, Scopus, Cochrane database, Pub Med për punimet më cilësore dhe dhe faqet autoritative për shëndetin si WHO dhe CDC për raporte dhe direktiva lidhur me temën. Në fillim janë gjetur 360 artikuj, por kur është kufizuar perzgjedhja në pesë vitet e fundit, që të jenë evidenca shkencore sa më aktuale, janë perzgjedhur 38 artikuj, ku prej tyre janë perzgjedhur ata pesë të cilët kanë pasur përparsi që janë të cekura te pjesa e kriterëve të përfshirjes dhe mospërfshirjes.

Janë përdorur fjalët kyçe si: MMR vaccine, autism, vaccine safety, MMR and autism, ASD

Kriteret e përfshirjes dhe mospërfshirjes. Janë përfshirë vetëm studimet më të mëdha, më të rëndësishme, të dekadës së fundit, me mostra të mëdha. Kryesisht janë perzgjedhur punime reviale që kanë përfshirë brenda tyre shumë studime kohorte të gjata dhe meta-analiza.

Tabela 1. Sëmundjet, shkaktarët, simptomat, komplikimet nga të cilat mbron vaksina MMR

Sëmundja	Virusi shkaktar	Simptomat kryesore	Komplikimet më të shpeshta
Fruthi	Paramiksovirusi	Ethe, temperaturë, kollitje, konjuktivit, rrjedhje hundësh, skuqje e lëkurës, ekzantemë tipike	Infeksion veshi, humbje dëgjimi, diare, pneumoni, dëmtim truri, vdekje
Rubella	Rubivirusi	Ethe, temperaturë, dhimbje fyti, skuqje, kokëdhimbje, skuqje sysh me dhimbje	Të lehta përveç në shtatzëni – shkaktan sindromën kongjenitale (CRS), shurdhim, defekte zemre

Korrespondenca:
shpresa.kushaj@rks-gov.net

MMR DHE AUTIZMI: VËRTETIMI SHKENCOR KUNDËR DEZINFORMIMIT



Fetije Fetaj

Specialist i Epidemiologjisë

Nuk janë përfshirë punime që flasin vetëm për autizmin apo spektrin e çrregullimeve autike në detaje, e po ashtu, as ato që flasin vetëm për vaksinën MMR në detaje, pasi ato nuk i përgjigjen qëllimit të këtij punimi rishikues.

Nxerrja dhe përpunimi i të dhënave

Të dhënat janë përpunuar vetëm në mënyrë kualitative, jo në mënyrë statistikore. U është dhënë prioritet punimeve më cilësore.

Definimi i sëmundjeve

Vaksina MMR është një vaksinë e cila për herë të parë u licencua në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në vitin 1971. Kjo vaksinë mbron nga tre sëmundje të ndryshme virale, por shumë ngjitëse: Parotiti, Fruthi dhe Rubella.


Fruthi është një sëmundje me kontagjiozitet 97 për qind, e cila shkaktohet nga paramixovirusët dhe shfaqet me simptoma si: ethe, temperaturë, skuqje të lëkurës, me ekzantemë tipike, kollitje, rrjedhje hundësh dhe konjunktivit. Komplikimet e saj përfshijnë infeksion veshi deri në humbje të dëgjimit, diare, pneumoni, dëmtim të trurit dhe vdekje.

Parotiti është një sëmundje ngjitëse e shkaktuar nga paramiksovirusët, e cila paraqitet me simptoma si: ethe, temperaturë, dhimbje muskujsh, plogështi, humbje e orkesit dhe ënjtje e gjëndrave të pështymës. Komplikimet e saj përfshijnë: ënjtje të testiseve ose vezoreve, shurdhim, inflamacion të trurit dhe cipave të trurit, inflamacion të palcës kurriozore, pra encefalit, meningjit dhe vdekje.

Rubella është një sëmundje ngjitëse e shkaktuar nga rubivirusët, e cila shfaq simptoma si: ethe, temperaturë, dhimbje fyti, skuqje, kokëdhimbje dhe skuqje të syve, e shoqëruar me dhimbje. Komplikimet e saj janë të lehta në përgjithësi, përveç në shtatëzani ku shkakton sindromën e rubellës kongjenitale (CRS) që shkakton shurdhim, ngcje në zhvillimin e fetusit dhe defekte në zemër.

Vaksina, Autizmi apo spektri i çrregullimeve

Grafiku 1. Mbrojtja kumulative e vaksinës MMR për fruthin, parotitin dhe rubellën



autike

Vaksina e cila i përfshin tre komponentët që i luftojnë të tri sëmundjet, pra vaksina MMR është një vaksinë e gjallë, e zbutur, e cila në përmbajtjen e saj ka: virusin e zbutur të fruthit (zingjirin Ender's Edmonston), virusin e zbutur të parotitit (zingjirin Jeryl Lynn) dhe virusin e zbutur të rubellës (zingjirin Wistar RA 27/3), stabilizuesit si: sorbitol, sukrozë dhe xhelatinë dhe antibiotikun neomicinë për të ndaluar ndotjen e vaksinës me bakterie.

Vaksina MMR është një vaksinë efikase, ku një dozë mbron 93% nga marrja e virusit, kurse dy doza deri në 97% ..

Po ashtu, vaksina MMR është një vaksinë tejet e sigurtë, ku efektet më të shpeshta anësore të raportuara janë: dhimbje në krahë për shkak të shpuarjes me gjilpërë, skuqje e lehtë, ethe, temperaturë dhe ënjtje të gjëndrave të qafës dhe të faqeve. (1). Grafiku 2. Efikasiteti i vaksinës MMR pas dozës së parë dhe të dytë për secilin komponent (Fruthi, Parotiti dhe Rubella). Të dhënat demonstrojnë mbrojtje të lartë, veçanërisht pas dozës së dytë, duke theksuar rëndësinë e përfundimit të skemës së vaksinimit për mbrojtje optimale.

Autizmi, apo spektri i çrregullimeve autike (ASD), është një çrregullim i trurit, i cili karakterizohet me sfida të komunikimit shoqëror dhe sjelljes, aktivitete të kufizuara dhe të përsëritura. Sjellet tipike për çrregullimet autike përfshijnë: mungesë interesimi për të tjerët dhe për sfidat shoqërore, veprime stereotipike si përplasja e dorës dhe lëkundja e trupit, insistim në gjënë e njëjtë, rezistencë për të ndryshuar dhe në disa raste agresivitet dhe vetë-lëndim. Në 40 për qind të rasteve, individët me autizëm kanë edhe paafësi kognitive. Autizmi është katër herë më i shpeshtë te djemtë dhe nuk ka diferenca në mes të racave, kulturave, etnive, apo grupeve sociale. Nuk ekziston thjesht një shkak për autizmin, por evidencat shkencore më të fundit mbështesin se origjina e tij është gjenetike. Prevalenca e autizmit është në rritje, ku sipas një raporti të

CDC të vitit 2023, një në 36 fëmijë tetë vjeçar është i prekur me autizëm. Kjo është një ngritje nga 1 në 44 fëmijë që ka qenë në vitin 2021, dhe një nga sqarimet për këtë rritje besohet të jetë një diagnostifikim më i mirë dhe një ndryshim në definicionin e autizmit. Shkaktarët janë gjenetikë, pra ndryshime në gjene të caktuara, por edhe kombinimi me faktorë të ambientit si për shëmbull: kemikatet toksike, sëmundjet e nënës, moshë e prindërve në momentin e ngjizjes së fëmijës, të cilat kushte mund të rrisin gjasën e diagnostifikimit me autizëm.(2) Një artikull revial që flet për kohën kur fillojnë simptomat e autizmit të fëmijët që të bëhen të dukshme, thekson se ato fillojnë që nga muaji i gjashtë e deri në muajin e tetëmbëdhjetë, por bëhen më të dukshme pasi fëmija i mbush një vit. Kjo është edhe arsyeja se përse te shumë prindër mund të shkaktohet keqkuptimi se autizmi është shfaqur pas marrjes së vaksinës MMR, doza e parë e së cilës merret nga 12-15muaj. (3) (4) (5)


Diskutimi:

Në të gjitha studimet e përzgjedhura për këtë punim siç janë: Vakinat nuk janë të lidhura me autizmin, Taylor et.al, një meta- analizë që ka përfshirë 10 kohorte dhe 5 studime raste-kontroll, i bërë në vitin 2014, me një mostër prej 1,256,407 nga studimet kohort dhe 9920 nga studimet rast kontroll, (6) po ashtu studimi i bërë në vitin 2015, US Siblings Cohort Study, ku në këtë studim janë analizuar 95,727 fëmijë, duke përfshirë edhe fëmijë që kanë pasur një motër apo vëlla me autizëm, si nëngrupe më të rrezikuara dhe akoma edhe te keto raste nuk është gjetur ndonjë lidhje mes vaksinimit me MMR dhe autizmit.(7) Evidenca shkencore

Tabela 2. Përmbajta e vaksinës MMR

Komponenti i Vaksinës	Përbërja	% e mbrojtjes nga Doza e Parë	% e mbrojtjes nga Doza e Dytë
Vaksina kundër fruthit	Virusi i zbutur, Zingjiri Ender's Edmonston	93%	97%
Vaksina kundër parotitit	Virusi i zbutur i parotitit	97%	Deri në 99%
Vaksina kundër rubellës	Virusi i zbutur i rubellës	97%	Deri në 99%

Grafiku 2. Efikasiteti i vaksinës MMR pas dozës së parë dhe të dytë për secilin komponent (fruthi, parotiti dhe rubella



mbi këtë temë janë shtuar, edhe me studimin kombëtar të Danimarkës, Denmark Nationwide cohort study, (8) i realizuar në vitin 2019, nga Hvidd et al., ku ishin përfshirë 657 461 fëmijë nga Danimarka të lindur midis viteve 1999-2010 dhe dy rishikime sistematike të vitetve të fundit, vitit 2021, një rishikim gjithëpërfshirës mbi sigurinë e vaksinave nga Gidengil et. Al, i cili ka përzgjedhur 67 studime të rëndësishme (9) dhe rikshikimi sistematik i publikuar në Cochrane Database, nga autorët Di Pietrantonj et al.po ashtu në vitin 2021, i cili ka përfshirë 138 studime. (10) Të gjitha hulumtimet kanë ardhur tek i njëjti përfundim, se nuk ekziston lidhje kauzale mes vaksinës MMR dhe autizmit apo çrregullimeve të ngjashme.

Përfundimet:

Debati se a shkakton vakina MMR autizmin apo jo, për shkencën është një debat i mbyllur, i mbështetur nga shumë studime të vazhdueshme përgjatë dekadës së fundit, pra: jo, nuk ka lidhje shkakësore mes vaksinës MMR dhe autizmit. Si profesionistë na takon të luftojmë dezinformimit dhe keqinformimet e ndryshme. Vakina MMR është vaksinë e sigurtë, e dëshmuar po thuajse 60 vjet, shumë efikase dhe shumë e sigurtë. Vaksinimi është e vetmja zgjidhje për të evituar shpërthimet epidemike të kohë pas kohshme që janë sfidë dhe shqetësim për shëndetin publik. Për të arritur këtë synim rekomandohen masa si: edukimi i vazhdueshëm për profesionistët shëndetësor, protokolle komunikimi me prindërit hezitues, rritja e transparencës në monitorimin e efekteve anësore të vaksinave dhe fushata të bazuara në evidencë që shpjegojnë qartë çfarë është dhe çfare nuk është autizmi.

Referencat:

- Centers for Disease Control and Prevention (CDC). Vaccine Safety – MMR Vaccine. Atlanta (GA): CDC; [cited 2025 May 26]. Available from: <https://www.cdc.gov/vaccine-safety/vaccines/mmr.html>
- Autism Science Foundation. Autism Basics [Internet]. New York: ASF; [cited 2025 May 26]. Available from: <https://autismscience-foundation.org/autism-basics/>
- Shaw KA, Williams S, Patrick ME, et al. Prevalence and early identification of autism spectrum disorder among children aged 4 and 8 years – Autism and Developmental Disabilities Monitoring Network, 16 sites, United States, 2022. MMWR Surveill Summ. 2025;74(SS-2):1–22. doi:10.15585/mmwr.ss7402a1
- Webb SJ, Jones EJ. Early identification of autism: early characteristics, onset of symptoms, and diagnostic stability. Infants Young Child. 2009;22(2):100–118. doi:10.1097/IYC.0b013e-3181a02f7f. PMID: 28090148; PMCID: PMC5232420
- Tanner A, Dounavi K. The emergence of autism symptoms prior to 18 months of age: a systematic literature review. J Autism Dev Disord. 2021;51(3):973–993. doi:10.1007/s10803-020-04618-w. PMID: 32734422; PMCID: PMC7954747
- Taylor LE, Swerdfeger AL, Eslick GD. Vaccines are not associated with autism: an evidence-based meta-analysis of case-control and cohort studies. Vaccine. 2014;32(29):3623–3629. doi:10.1016/j.vaccine.2014.04.085. PMID: 24814559
- Jain A, Marshall J, Buikema A, Bancroft T, Kelly JP, Newschaffer CJ. Autism occurrence by MMR vaccine status among US children with older siblings with and without autism. JAMA. 2015;313(15):1534–1540. doi:10.1001/jama.2015.3077
- Hviid A, Hansen JV, Frisch M, Melbye M. Measles, mumps, rubella vaccination and autism: a nationwide cohort study. Ann Intern Med. 2019;170(8):513–520. doi:10.7326/M18-2101. PMID: 30831578



Figura 1. Pamje e një fëmiu me fruth (KidsHealth New Zealand. (n.d.). Measles in children. KidsHealth NZ. Retrieved May 25, 2025, from <https://www.kidshealth.org.nz/measles-in-children>)



Figura 2. Ekzantema e fruthit. (KidsHealth New Zealand. (n.d.). Measles in children. KidsHealth NZ. Retrieved May 25, 2025, from <https://www.kidshealth.org.nz/measles-in-children>)

Tabela 3. Përmbledhja e gjetjeve të punimeve kryesore.

Titulli	Autorët	Viti i publikimit	Lloji i punimit (dizajni)	Nr. i mostrës	Gjetjet	Burimi
Vaksinat nuk janë të lidhura me autizmin	Taylor et al.	2014	Meta-analizë (10 kohortë dhe 5 studime rast-kontrollë)	1,256,407 nr. i fëmijëve nga 5 kohortë dhe 9920 fëmijë nga studimet rast-kontrollë	Nuk ka asnjë lidhje shkakësore mes vaksinës MMR dhe autizmit.	Taylor LE, Swerdfeger AL, Eslick GD. Vaccines are not associated with autism: an evidence-based meta-analysis of case-control and cohort studies. <i>Vaccine</i> . 2014 Jun 17;32(29):3623-9. doi: 10.1016/j.vaccine.2014.04.085. Epub 2014 May 9. PMID: 24814559.
Studimi kohort amerikan mes vëllezërve-motrave	Jain. et al.	2015	Kohort prospektiv	95,727 fëmijë duke përfshirë fëmijët që kanë pasur një vëlla ose motër me autizëm	Nuk ka asnjë lidhje shkakësore mes vaksinës MMR dhe autizmit akoma edhe në nëngrupet me rezik	https://jamanetwork.com/journals/jama/fullarticle/2275444
Studimi Kohort Kombëtar i Danimarkës	Hviid et al.	2019	Kohort prospektiv	657 461 fëmijë në Danimarkë	Nuk ka lidhshmëri mes MMR vaksinës dhe autizmit	https://www.acpjournals.org/doi/full/10.7326/M18-2101?rft_dat=cr_pub++0pubmed&url_ver=Z39.88-2003&rft_id=on%3Aand%3Acrossref.org
Rishikim sistematik i sigurisë së vaksinave	Gidengil et al.	2021	Rishikim sistematik	67 studime të përzgjedhura për rishikim	Nuk ka dëshmi për rritje të rrezikut të autizmit pas vaksinimit me MMR	https://vaccinateyourfamily.org/questions-about-vaccines/vaccine-research/
Rishikim në Cochrane	Di Pietrantonj et al.	2021	Rishikim sistematik	138 studime me	Nuk ka dëshmi për rritje të	https://www.cochranelibrary.com/cdsr/doi/10.1002/14651858.CD004407.pub5/full?highlightAbstract=mmr%7Csafety%7Csafety